



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org: Org. Jedinica Org Unit:	01
Nr Prot: Broj Prot: Prot. No:	05-212
Nr. i faqeve Br. stranic No. pages:	- 33 -
Data: Datum: Date:	13/01/2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Datë	13.01.2017
Numri i referencës	MSH/DSHB/mgj/ 06101/2017
PËR/ZA/TO:	Te gjithë Udhëheqësit e NjShB-ve - <i>Hedrije Malohy Malohy</i> Te gjithë Kryeinfermieret e NjShB-ve Te gjithë Drejtorëve te Burgjeve
CC:	Dr. Imet RRAHMANI, Ministër i Shëndetësisë Z. Ardian MEHMETAJ, UD, Sekretar i Përgjithshëm i MSh Z. Sokol ZOGAJ, Drejtor i ShKK/MD
PËRMESPREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr. Sci. <i>[Signature]</i> Udhëheqës i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Procedurat e punës dhe Përshkrimet vendeve te punës ne DShB

Te nderuar,

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgoj këto dokumente:

1. Procedurat e punës ne DShB bazuar ne UA 05/2014 dhe ligjet ne fuqi,
2. Përshkrimet e vendeve te punës për te gjitha pozitat ekzistuese ne DShB

Këto dokumente janë dokumente pune obligative dhe te përkohshme deri ne përfundim te projektit me Këshillin e Evropës me ç ‘rast janë duke u harmonizuar këto dokument me ato te Këshillit te Evropës dhe BE-se.

Ne ndërkohë do te merrni edhe dokumentin baze lidhur me pajisjet dhe hapësirat ne NjShB sipas akteve nënligjore te MSh-se.

Ju lutem qe te i implementoni te gjitha këto dokumente te cilat janë akte bazike juridike te punës ne DShB pas UA/05/2014, ligjit për shëndetësi dhe ligjeve tjera ne fuqi.

Ju faleminderit për mirëkuptim

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS TË STAFIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE
TË KOSOVËS**

Table of Contents

PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS TË STAFIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE TË KOSOVËS	1
1. DREJTOR I DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TE BURGJEVE	4
2. KOORDINATOR PËR SHËNDET MENDOR NE BURGJE.....	5
3. KOORDINATOR PËR SHËRBIME FARMACEUTIKE NE BURGJE.....	6
4. KOORDINATOR PËR TE DHËNA DHE TERMINE NE SHSKUK	7
5. UDHËHEQËS I NJSHB NË DUBRAVË.....	8
6. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER KORREKTUESE	10
7. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER PARABURGIMI	11
8. MJEK NË NJSHB	12
9. PSIKOLOG NË NJSHB	13
10. DENTIST NË NJSHB.....	14
11. PSIKIATER KONSULTANT	14
12. TEKNIK I RADIOLOGJISE.....	15
13. GJINIKOLOG KONSULTANT.....	16
14. RADIOLOG KONSULTANT.....	17
14. ORTOPEDE KONSULTANT	18
15. OFTALMOLOG KONSULTANT	19
16. UROLOG KONSULTANT.....	19
17. OTORINOLARINGOLOG KONSULTANT	20
18. KIRURG KONSULTANT	21
19. FIZIATER KONSULTANT.....	22
20. FIZEOTERAPEUT KONSULTANT	23
21. PULMOLOG KONSULTANT	23
22. KARDIOLOG KONSULTANT.....	24

23.	NEUROLOG KONSULTANT.....	25
24.	KRYEINFERMIER NË STACIONARIN E NJSHB NË DUBRAVË.....	26
25.	KRYEINFERMIER NË NJSHB NË QENDER PARABURGIMI	27
26.	SHEF NDRRIMI NË NJSHB.....	28
27.	TEKNIK I FARMACISË NË NJSHB	29
28.	INFERMIER NË NJSHB	30
29.	LABORANT TEKNIK NË NJSHB.....	31
30.	INFERMIER I NJSHB-SE NE SHSKUK.....	32

1. DREJTOR I DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TE BURGJEVE

Vendi: **Ministria e Shëndetësisë**

Detyra dhe përgjegjësitë

1. Të jetë përgjegjës për të gjitha shërbimet shëndetësore në të gjitha Njësitë Shëndetësore të burgjeve.
2. Të menaxhoj punën e shëndetësisë në burgje dhe të koordinatoreve në DShB (Koordinatori për shëndetësi, shëndet mendor, farmaci dhe për të dhëna e terminë në SHSKUK)
3. Të menaxhoj dhe mbikëqyr punën e tërë stafit mjekësor që punon në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, gjegjësisht NjShB.
4. Monitorimi dhe menaxhimi i punës së institucioneve shëndetësore në burgje (8 ambulancave, 2 stacionareve shëndetësore, 1 institucioni për kujdes shëndetësor për personat me nevoja të veçanta dhe 1 institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijut);
5. Aplikimin e planit të veprimit nga strategjia sektoriale e MSH-se për shëndetësinë në burgje lidhur me funksionimin e këtij shërbimi në harmoni me rregullat e sigurisë së burgjeve;
6. Bashkëpunimin e ngushtë me Organin Qendror të Administratës Shtetërore /SHKK/MD dhe me drejtoret e burgjeve, të cilat janë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të ofrimit të kujdesit shëndetësor të njëjtit si për qytetaret e lirë si dhe bashkëpunimin me gjykatat dhe prokurorit për trajtimin, ekspertizën dhe raportimin shëndetësor dhe psikiatrike për persona të caktuar sipas kërkesës;
7. Aplikimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në aspektin shëndetësor;
8. Mbikëqyrjen dhe raportimin e rregullt të kushteve higjieniko-sanitare, ushqimit dhe ujit në burgje si dhe marrjen e masave të vazhdueshme për parandalimin e epidemive dhe marrjen e masave kundër epidemike në rast nevojë;
9. Dhënien e këshillave profesionale për rastet vështirë të menaxhueshme dhe rasteve që kërkojnë trajtim multidisiplinar dhe ndër sektorial;
10. Bashkëpunimin me të gjitha institucionet shëndetësore të vendit duke filluar nga ato të shëndetit primar, sekondar, terciar si dhe menaxhimin e dhomave të sigurta në institucione shëndetësore publike dhe menaxhimin për trajtim të burgosurve në institucione shëndetësore publike;
11. Mbështetje në menaxhimin e situatave të komplikuar në burgje të cilat lidhen me shëndetin si grevat e urisë, tentim vetëvrasjet, dhunën në burgje, vdekjet në burgje etj.
12. Funksionimi i këtij Departamenti realizohet përmes Njësive Shëndetësore të vendosura në secilin burg (10).
13. Aktivitetet nga përgjegjësia e Departamentit menaxhohen në bashkëpunim me koordinoret përgjegjës për çështje specifike;
14. Emeron pozitave udhëheqëse të NjShB (mjekun përgjegjës dhe kryeinfermierin);
15. Udhëheqësi i Departamentit shëndetësor të burgjeve raporton tek Ministri i Shëndetësisë.

Kushtet: